



Titulli i projektit

Peshkëzimi artificial i Liqenit të Fierzës dhe ujëmbledhësve të Zonës Funksionale Kukës

Tipi i projektit

Mjedisor / Zhvillim i Ekonomisë Lokale

Vendndodhja e projektit

Kukës

Buxheti i paravlerësuar

200,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Përvojat evropiane kanë treguar se të gjitha zonat rurale që kanë shfrytëzuar sipërfaqet ujore në akuakulturë kanë pasur një bum ekonomik të dukshëm. Por në Zonën Funksionale Kukës, vitet e fundit është vënë re një varfërim tepër i madh imjediseve ujore me peshk, të cilat kanë qenë një burim imirëfilltë mirëqenieje e të ardhurash nga punësimi. Kjo ka ardhur si pasojë e peshkimit të pakontrolluar, por edhe e mos furnizimit me peshk (rasate) të Liqenit. Peshkimi pa kriter nga banorët e zonës dhe mjetet e përdorura kanë sjellë reduktim të llojit të peshkut në Liqenin e Fierzës. Para viteve '90, ka ekzistuar Ndërmarrja e Peshkimit me qendër në Shkodër dhe filial në Kukës, që mbronte dhe kultivonte rasatin e peshkut. Kjo ndërmarrje nuk ekziston më, duke qenë kështu një faktor tjetër që ka ndikuar në reduktimin e peshkut. Për të shfrytëzuar sa më mirë ujërat e Liqenit të Fierzës dhe të ujëmbledhësve të tjerë, lind nevoja e një studimi për kthimin e rezervateve të vogla, kryesisht të rezervuarëve ekzistues, ose dhe krijimin e rezervuarëve të rinj.

Qëllimi/et specifik të projektit

Të rritet prodhimtaria peshkore në Liqenin e Fierzës dhe në të gjithë ujëmbledhësit e tjerë të rajonit.

OS2: Të ngrihet niveli ekonomik i të gjithë komunitetit të popullsisë banuese përreth pellgut ujëmbledhës të Liqenit.

OS2: Të rindërtohet dhe të vihet në funksion Qendra Artificiale e Kultivimit të Larvave dhe Rasateve të Peshqve.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

R1: Ekonomia e peshkimit në Liqenin e Fierzës është rehabilituar

R2: Rritje e të ardhurave e të familjeve që jetojnë me peshkim

R3: Legalizim i peshkimit personal dhe industrial

R4: Përmirësim në aspektin mjedisor përmes pasurimit të faunës në Liqenin e Fierzës

PROJEKTI 10



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

1. Takime dhe seminare me grupet e interesit
2. Studim, projektim dhe rehabilitim i rezervuarëve të qendrës së prodhimit industrial të akuakulturës
3. Sensibilizim dhe takime bashkëpunimi për parandalimin e dëmtimit të rasteve

Projekti mendohet të zbatohet në një periudhë 2-vjeçare.

Maturimi i projektit

Aktualisht i vetmi projekt që po zbatohet është nga shoqata e peshkatarëve dhe lidhet me trajnimin e të rinjve për kultivimin dhe ritjen e peshkut.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Financuesit e projektit:
Nuk ka ende fonde të siguruar nga donatorët.

Projekti do të zbatohet nga:

- Agjencia e Zhvillimit Rajonal Kukës.
- Këshilli i Qarkut Kukës
- Bashkia Kukës

Kostot e projektit

Studim, projektim dhe rehabilitim i rezervuarëve të qendrës së prodhimit industrial të akuakulturës 180,000€

Sensibilizim dhe takime bashkëpunimi për parandalimin e dëmtimit të rasteve 20,000€